



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

Komuna e Kamenicës  
Opština Kamenica  
Kamenica Municipality



## DREJTORIA E ARSIMIT

Nr. 318  
Kamenicë,  
16.10.2024

REPUBLICA E KOSOVES  
REPUBLIKA E KOSOVES  
QENDRA PER SHERBIM TE QYTETARET  
CENTAR ZA USLUGU GRADANA

Sh. 04 Nr. 33234  
U. 04 Br. 33234

Nr. i faq. 2 Data: 16/10  
Br. str. Datum:  
KAMENICE/A 2024

Duke u bazuar në nenin 62 par 3, nenit 17 pika s të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, nenit 64.4 , nenit 19 pika 1.19, të Statutit të Komunës së Kamenicës 01 nr.20203 dt 21.06.2023, nenit 14 paragrafi 1.1 të Rregullores për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së Subvencioneve shifra 01 nr. 31251 të dates 29.09.2023, Drejtoria e Arsimit, shpallë:

### KONKURS

#### PËR NDARJEN E BURSAVE PËR STUDENTË TË KOMUNËS SË KAMENICËS

PËR VITIN AKADEMIK 2024 – 2025

#### Kriteret e përgjithshme

Përfitues të bursave mund të jenë:

- Studentët e rregullt të regjistruar në UKZ, viti akademik 2024/25;
- Vetëm studentët e rregullt - viti i dytë ( II ) e tutje të regjistruar në fakultetet e Universiteteve Publike të Republikës së Kosovës, duke përjashtuar studentët në studimet pasuniversitare - master dhe doktoraturë;
- Studentët duhet të mos jenë përsëritës të vitit akademik;
- Të jenë banorë të komunës së Kamenicës.

#### Kriteret e veçanta

1. Vërtetimi ose ID kartela (kopje) si dëshmi për regjistrimin në UKZ në vitin e parë të studimeve 2024-25
2. Nota mesatare
  - 2.1 Nota mesatare, prej 9 deri 10.....30 pikë
  - 2.2 Nota mesatare, prej 8 deri 9.....20 pikë
  - 2.3 Nota mesatare, prej 7 deri 8.....15 pikë
  - 2.4 Nota mesatare, prej 6 deri 7.....10 pikë
3. Numri i studentëve në familje (2 e më shumë).....10 pikë
4. Kategoritë e dala nga lufta.....10 pikë
5. Student në asistencë sociale.....10 pikë
6. Student ne fushat ku ka mungesë të kadrove.....10 pikë

(Mjekësi e përgjithshme, TIK, matematikë, fizikw, kimim, biologji, ndërtimtari dhe arkitekturë, mekanikë, FIEK )

7. Student me nevoja të veçanta.....10 pikë
8. Student pa dy prindërit.....20 pikë
9. Student pa njërin prind.....10 pikë

**Vëmendje:** Kriteret e veçanta sipas pikës dy (2), vlerësohen vetëm për një student të asaj Familje dhe vetëm nëse dëshmon me dokumentacion zyrtar se të gjithë studentët e asaj familje i plotësojnë kriteret e përgjithshme.

**Dokumentet e nevojshme për aplikim :**

- Aplikacioni sips formës së komunës së Kamenicës;
- Kopja e ID-së së studentit;
- Vërtetimin se studenti ka regjistruar vitin akademik 2024 -2025 (origjinale);
- Kopja e dokumentit të identifikimit;
- Certifikata e notave (origjinale);
- Certifikata e vendbanimit;
- Vërtetim se është anëtar i ngushtë i familjes së kategorive të dala nga lufta;
- Vërtetim për shfrytëzimin e ndihmës sociale të lëshuar nga Qendra për Punë Sociale
- Për studentët pa njërin ose dy prindërit-certifikata e vdekjes;
- Për studentët me nevoja të veçanta- vendimi/ vërtetimi zyrtar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

**Vërejtje:** Dokumentet e pakompletuara sipas kriterëve të lartcekura, dhe ato të dorëzuara pas afatit zyrtar nuk do të shqyrtohen.

**Vini re**

Dokumentet dorëzohen në Qendrën e shërbimit për qytetarë në objektin e Komunës së Kamenicës - Rr."Skenderbeu", në afat prej 15 ditësh nga dita e publikimit në tabelën e shpalljeve të objektit të Komunës, në mediat e shkruara dhe në web-faqen e Komunës

<http://kk.rks-gov.net/Kamenicë>,

*Lartësia e bursës do të caktohet varësisht nga buxheti i Drejtorisë për Arsim dhe nga numri i atyre që i plotësojnë kushtet për përfitimin e bursës.*

Drejtori i Drejtorisë së Arsimit  
  
Afrim Dervishi

